



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900291/6

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Rekomandohet: *"Marrja e masave në përputhje me ligjin, me qëllim kryerjen sa më shpejt të veprimeve hetimore për përfundimin e hetimit të procedimit penal nr.3447, të vitit 2018, në zbatimin të dispozitave kushtetuese e procedurale, për një proces të rregullt ligjor.*

Hetimi i shkeljes disiplinore ndaj z.P. H., me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Drejtuar : Prokurorit të Përgjithshëm
Znj. Arta MARKU

Tiranë

Për dijeni: Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Znj. Elisabeta YMERI

Këshillit të Lartë të Prokurorisë
Z. Gent IBRAHIMI

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (kur të krijohet)

Tiranë

E nderuar Znj.MARKU,

Në veprimtarinë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë trajtimit të ankesave, qytetarë të ndryshëm kanë paraqitur shqetësime apo ngritur pretendime ndaj organit të Prokurorisë, për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal, filluar mbi bazën e kallëzimit penal të tyre.

I tillë është rasti i ankesës së shtetasit I. B. nga Tirana, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me datë 21.02.2019, në të cilën ka ngritur shqetësimin dhe ankohet ndaj z. P. H., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi në mënyrë të pajustificuar ka zvarritur hetimin e procedimit penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, filluar mbi bazën e kallëzimit penal, paraqitur në muajin Mars 2018.

Më datë 26.02.2019, me shkresën nr.K2/I9-3, i kemi kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila më datë 19.03.2019, me shkresën nr.4220 (bashkëlidhur kopje e shkresës dhe vendimit të rregjistrimit të procedimit penal) informon Institucionin e Avokatit të Popullit se:

“Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit I.B., më datë 30.03.2018, ka rregjistruar procedimin penal nr.3447, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa autor.

Me hetimin e procedimit penal është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore Sh. K.. Gjatë hetimit të këtij procedimi janë kryer një sërë detyrash si, pyetja e personave që kanë dijeni për rrethana të hetimit, këqyrja dhe administrimi i një sërë dokumentesh në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Hetimi është në fazën përmbyllëse. Duke mos qënë regjistruar emri i ndonjë personi konkret të cilit i atribuohet vepra penale nuk është marrë ndonjë zgjatje afati”.

Më datë 23.05.2019, jemi interesuar në sekretarinë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe jemi informuar se procedimi penal nr.2415, regjistruar me nr. 3447, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nuk ishte përfunduar në vitin 2018, dhe aktualisht ishte në hetim nga prokurori z.P.H..

Duke analizuar ankesën e shtetasit I. B., arrijmë në disa konstatime e përfundime, dhe konkretisht:

Së pari: Në mosrespektimin me korrektësi të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, nga prokurori për regjistrimin e njoftimit të veprës penale.

Në materialin kallëzues referuar nga Policia e Shtetit, regjistruar në organin procedues më datë 16.03.2018, shtetasi I. B. ka kërkuar fillimin e hetimit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” ndaj shtetasit me emrin Arbri, me detyrë faturues pranë OSHEE, i cili ka kryer veprimin e kundërligjshëm. Ka qënë detyra e organit të Prokurorisë që brenda një afati prej 15 ditësh të kryente verifikimet e nevojshme për të sqaruar gjeneralitetet e këtij personi, dhe mandej tek urdhëri për rregjistrimin e procedimit penal, në respekt të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale të pasqyronte emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Për rrjedhojë, data 30.03.2018, do të ishte dhe dita që do të fillonte afatit i hetimit, duke e vënë organin procedues në detyrimin për të përfunduar hetimet brenda 3 muajve, sipas nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Së dyti: Në mosushtrimin e kompetencave nga prokurori me standarte profesionale më të larta.

Zvarritja në kryerjen e veprimeve të mundshme apo të domosdoshme, tregon se nuk janë marë masat e duhura për t’u siguruar se janë kryer veprime, e për rrjedhojë nuk ka përgjegjshmëri dhe efikasitet në punë.

Rasti që analizohet bën fjalë se, organi procedues ka filluar procedimin penal, por kallëzuesi duke parë se po zvarritej hetimi i çështjes, jo në pak raste është interesuar për “*fatim*” e hetimit, duke marrë përgjigje steriotipe se “*po kryhen një sërë veprimesh hetimore*”, pa adresuar kohën e marrjes së një vendimi përfundimtar.

Prokuroria në përgjigjen e saj ndërsa flet për veprime hetimore të kryera të cilat janë të nevojshme, nuk i referohet hetimeve komplekse ose pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato, çka do të përbënin një bazë të besueshme se hetimet duhet të zgjatëshin, pasi të kishte respektuar kërkesën e nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Sipas prokurorisë, me hetimin e procedimit penal të mësipërm është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore z. Sh. K. duke anashkaluar prokurorin, i cili sipas nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Prokurori gjithashtu ka dhe detyrimin për të kërkuar kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht dhe të ndjekë realizimin e tyre sipas afateve të përcaktuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion i pavarur kushtetues, ka për mision mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve në procesin penal, në rastin konkret qytetarit I. B., i cili bazuar në nenin 283 të Kodit të Procedurës Penale, pasi ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, e ka kallëzuar atë në prokurori.

Kushtetuta e Republikës të Shqipërisë në nenet 28 dhe 42 të saj, përcakton detyrimin për gjykimin e personit të paraburgosur apo të akuzuar penalisht brenda një “*afati të arsyeshëm*”. Ndonëse ndodhemi në fazën e hetimit paraprak, kur ende nuk është marrë person konkret nën hetim, mendojmë se ky afat nënkupton një hark kohor të nevojshëm për zhvillimin e një procesi penal, i cili duhet të sigurojë një barazi të palëve në proces. Ky rregull shpreh parimin e barazisë së palëve në proces duke i dhënë hetimit dhe gjykimit afatin e nevojshëm, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare të organit procedues.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese, e cila e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, duke filluar nga verifikimi i kallëzimit penal brenda afatit të përcaktuar prej 15 ditësh dhe më pas, të konkludojë për mënyrën e zgjidhjes së tij; vënia në dijeni e individit të dyshuar për kryerjen e veprës penale për shkakun e akuzës së ngritur ndaj tij; respektimin e të drejtave procedurale dhe zhvillimin e hetimit dhe gjykimit brenda një “*afati të arsyeshëm*”, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasit ndaj veprimeve të padrejta dhe të paligjshme të organeve të pushtetit shtetëror dhe si detyrim i këtyre të fundit për të mos cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve pa siguruar respektimin e procedurave ligjore. Prosesi i rregullt ligjor është një karakteristikë e pandashme e shtetit të së drejtës.

Në pikën 2 të nenit 4 të Ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, thuhet: “*Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke*

respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik”.

Në nenin 7/gj të Urdhërit nr.141 datë 19.06.2014 “Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, thuhet: *“Prokurorët duhet të mbështesin parimin e një procedimi dhe gjykimi të drejtë, siç është përcaktuar në Kushtetutë, KEDNJ dhe ligj”.*

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e reflektuar kjo dhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, kanë përcaktuar kritere të cilat bëjnë fjalë për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedimit, me qëllim që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt duke u siguruar dhe një shpejtësi e mjaftueshme. Për të mënjeluar cënimin e kriterit të afatit të arsyeshëm veprimet e organit procedues nuk duhet të rezultojnë të pamjaftueshme, pasi krijojnë hapësira për zvarritje të procesit të hetimit të çështjes.

Një parim i rëndësishëm i shtetit të së drejtës i pranuar nga Gjykata Kushtetuese është edhe respektimi i parimit të sigurisë juridike, i cili presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Siguria juridike nënkupton ndërmjet të tjerave garantimin e besueshmërisë së individëve tek shteti, institucionet e tij, si dhe aktet që ato nxjerrin. Për analogji dhe paraqitja e kallëzimit penal i shtetasit në organin procedues është ushtrimi i një të drejte për çdo rast dijenie të një veprë penale.

Rregullorja e Prokurorisë së Përgjithshme *“Për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësiwe profesionale e morale të prokurorëve”*, e datës 17.06.2014, përcakton në mënyrë të qartë se kush përfshihet në procedimet komplekse. Por, nga ana tjetër në rregullore përcaktohen dhe detyrimet e Prokurorit për të kryer një punë me cilësi, për planifikimin e saj dhe caktimin e afateve kohore për çdo çështje, për të drejtuar me efektivitet hetimet, për të organizuar, drejtuar dhe kontrolluar punën e policisë gjyqësore e në përfundim për të respektuar shpejtësinë dhe afatet e arsyeshme ligjore dhe atyre të motivuara të hetimeve paraprake deri në zgjidhjen ligjore të çështjes.

Pavarësisht pretendimit të Prokurorisë për kryerje të një sërë veprimesh hetimore, mendojmë se ka ekzistuar mundësia reale dhe objektive për të përfunduar hetimet në kohë më të shkurtër, nëpërmjet organizimit të mirë të punës, kryerjes së veprimeve hetimore në vazhdimësi etj.

Pavarësia e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, nënkupton respektimin e parimit të procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik. Është detyra e prokurorit më të lartë për të orientuar dhe udhëzuar me shkrim prokurorin e çështjes për të përfunduar sa më shpejt hetimin e procedimit penal.

Duke respektuar kërkesat e parashikuara në nenin 194 të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, në mungesë të formimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës, po bëhet prezent kjo problematikë që të bashkërendohet puna për të bërë të mundur evidentimin e shkeljes disiplinore kryer nga prokurori z. P. H.,

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa*

kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe nenin 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse, ku thuhet: “Avokati i Popullit.....paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.

REKOMANDOHET

“Marrja e masave në përputhje me ligjin me qëllim kryerjen sa më shpejt të veprimeve hetimore për përfundimin e hetimit të procedimit penal nr.3447 të vitit 2018, në zbatim të dispozitave kushtetuese e procedurale, për një proces të rregullt ligjor.

Hetimi i shkeljes disiplinore ndaj z.P. H., me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA